



Numri i lëndës: KSC-SC-2023-01/CS002

Vendosi: Kryetarja e Dhomave të Specializuara
Gjykatëse Ekaterina Trendafilova

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 12 dhjetor 2023

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Konfidencial

Vendim mbi Modifikimin e Dënimit

me Shtojca Konfidenciale dhe *Ex Parte*

Prokurores së Specializuar:

Kimberli P. Uest

Mbrojtësit të Hasim Haradinajt:

Tobi Kadman

KRYETARJA e Dhomave të Specializuara (“Kryetarja”), duke mbajtur parasysh nenin 51(2) të Ligjit nr. 05/L 053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”), rregullat 196 dhe 197 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”) dhe nenet 3, 6 dhe 9 10 të Udhëzuesit të Punës mbi Uljen e Dënimit (“Udhëzuesi i Punës”), pasi ka marrë Raportin e Administratores në lidhje me sjelljen e z. Nasim Haradinaj në objektin e paraburgimit, lëshon këtë vendim mbi modifikimin e dënimit të z. Haradinaj.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 18 maj 2022, Trupi Gjykses II shqiptoi Aktgjykimin në çështjen gjyqësore kundër z. *Hysni Gucati* dhe z. *Nasim Haradinaj*.¹ Trupi Gjykses i shpalli të dy të akuzuarit fajtorë për pengim të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare, frikësim gjatë procedurës penale dhe shkelje të fshehtësisë së procedurës, dhe i dënoi me një dënim prej katër vjetësh e gjysmë burgim, duke llogaritur kohën e kaluar në paraburgim, dhe me një gjobë prej 100 eurosh.²

2. Më 2 shkurt 2023, Paneli i Gjykatës së Apelit lëshoi Aktgjykimin e Apelit, me të cilin la në fuqi, pjesërisht, verdiktin e fajësisë së z. Gucati dhe z. Haradinaj, dhe, me shumicë, uli dënimet e tyre në katër vjet e tre muaj burgim, duke llogaritur kohën e kaluar në paraburgim.³ Paneli i Apelit gjithashtu la në fuqi për secilin prej tyre dënimin shtesë me një gjobë prej 100 eurosh.⁴

3. Më 5 korrik 2023, në përputhje me nenin 3(3) të Udhëzuesit të Punës, Administratorja njoftoi Kryetaren se z. Haradinaj do ta plotësonte kriterin për

¹ KSC-BC-2020-07, F00611/RED, Version i Redaktuar Publik i Aktgjykimit, 18 maj 2022.

² Aktgjykimi, para. 1012-1017.

³ KSC-CA-2022-01, F00114, Aktgjykimi i Apelit, 2 shkurt 2023, para. 442.

⁴ Aktgjykimi i Apelit, para. 442.

shqyrtim për ulje të dënimit më 25 korrik 2023, kur të kishte vuajtur dy të tretat e dënimit.⁵

4. Më 26 korrik 2023, Kryetarja i kërkoi Administratores të mblidhte dhe t'i dorëzonte informacionin e përcaktuar në rregullën 196(3) të Rregullores, si dhe të ndërmernte hapat e paraparë në nenin 4 të Udhëzuesit të Punës.⁶

5. Më 14 gusht 2023, Administratorja i dorëzoi Kryetares informacionin e mbledhur sipas rregullës 196(3) të Rregullores dhe nenit 5(1) të Udhëzuesit të Punës.⁷ Konkretisht, Administratorja dorëzoi: (i) Raportin e Njesisë së Paraburgimit ("NJP"), me Shtojcat A deri në E; (ii) Raportin e Zyrës së Prokurorit të Specializuar ("ZPS"); dhe (iii) Parashtrimet e vetë Administratores.

6. Më 28 gusht 2023, përmes Njesisë për Administrimin e Gjykatës, z. Haradinaj dorëzoi vërejtjet e veta në lidhje me parashtrimet e Administratores dhe raportet përkatëse ("Parashtrimet e Haradinajt").⁸

7. Më 30 gusht 2023, në përputhje me nenin 51(2) të Ligjit, rregullën 196(1) të Rregullores dhe nenin 6 të Udhëzuesit të Punës, informacionin e marrë Kryetarja ua dorëzoi gjykatësve të paneleve që dhanë dënimin dhe u kërkoi të jepnin mendimet e tyre në lidhje me uljen e dënimit të z. Haradinaj.

8. Më 28 shtator 2023, Kryetarja mbajti një seancë gjatë së cilës dëgjoi mendimet e z. Haradinaj mbi uljen, modifikimin ose ndryshimin e dënimit dhe përgjigjet ndaj pyetjeve që i drejtoi.

⁵ KSC/REG/IOR/6207, Njoftim në lidhje me Plotësimin e Kriterit për Shqyrtim për Ulje të Dënimit, 5 korrik 2023 (konfidencial).

⁶ KSC/CHA/PRE/0818, Njoftim në lidhje me Plotësimin e Kriterit për Shqyrtim për Ulje të Dënimeve të z. Gucati dhe z. Haradinaj, nr. KSC-SC-2023-01/CS001, 26 korrik 2023 (konfidencial).

⁷ KSC/REG/IOR/6297, Informacioni i Kërkuar sipas Nenit 5 të Udhëzuesit të Punës mbi Uljen e Dënimit në lidhje me z. Nasim Haradinaj, 14 gusht 2023 (konfidencial).

⁸ Parashtrim i Haradinajt në lidhje me Uljen e Dënimit, 28 gusht 2023 (konfidencial), me shtojca konfidenciale.

9. Më 12 tetor 2023, Kryetarja lëshoi Vendimin mbi Uljen, Modifikimin ose Ndryshimin e Dënimit (“Vendimi i Parë”) në të cilin, ndër të tjera, konstatoi se modifikimi i dënimit të z. Haradinaj për të mundësuar lirimin e tij me kushte nuk ishte i përshtatshëm në atë kohë, sepse z. Haradinaj në tre raste demonstroi se nuk e respektoi plotësisht kornizën normative të NJP së.⁹ Rrjedhimisht, Kryetarja urdhëroi Administratoren të paraqiste një raport pas dy muajsh, ku të informonte nëse z. Haradinaj i kishte respektuar rregullat dhe rregulloret gjatë asaj kohe.¹⁰

10. Kryetarja mori parasysh një sërë faktorësh që mund të peshojnë në favor të modifikimit të dënimit të z. Haradinaj me anë të lirit me kushte.¹¹ Në veçanti, Kryetarja theksoi se: (i) gjatë seancës gojore, z. Haradinaj kishte treguar shenja të distancimit nga veprat penale për të cilat u dënua; (ii) z. Haradinaj gjithashtu kishte treguar disa shenja rehabilitimi; (iii) gjasat që lirimi i z. Haradinaj të shkaktojë paqëndrueshmëri shoqërore të konsiderueshme në Kosovë janë të vogla; (iv) z. Haradinaj ka lidhje të forta familjare dhe shoqërore, që do të ndihmonin riintegrimin e tij në Kosovë; dhe (v) z. Haradinaj ka kaluar vështirësi që lidhen me të qenit larg familjes, veçanërisht bashkëshortes dhe vëllezërve të tij, të cilët kanë pasur probleme të rënda shëndetësore.

11. Më 22 nëntor 2023, Kryetarja lëshoi një vendim ku i tërhoqi vërejtje zyrtarisht mbrojtësit të z. Haradinaj, Tobi Kadman, që t’u përmbahet detyrimeve të tij sipas neneve 6, 12, dhe 13 të Kodit të Etikës Profesionale për Mbrojtësit dhe Prokurorët para Dhomave të Specializuara të Kosovës.¹² Vërejtja u dha pas një interviste të z. Kadman me një media në Kosovë, gjatë së cilës ai nxori informacion nga Vendimi i Parë që ishte i redaktuar.

12. Më 11 dhjetor 2023, Administratorja dorëzoi parashtrimet (“Parashtrimet”) dhe

⁹ Vendimi i Parë, para. 73.

¹⁰ Vendimi i Parë, para. 77-78.

¹¹ Vendimi i Parë, para. 74.

¹² F00004/RED, Version Publik i Vendimit në lidhje me Vërejtje Zyrtare, 22 nëntor 2022.

raportin në lidhje me sjelljen e z. Haradinaj në objektin e paraburgimit ("Raporti").¹³

II. PARASHTRIME

13. Administratorja parashtron se mediat raportuan gjerësisht lidhur me Vendimin e Parë më 13 tetor 2023, ndonëse versioni publik i tij doli vetëm më 17 tetor 2023.¹⁴ Administratorja thekson se "shpërndarja e paautorizuar e informacionit konfidencial lidhur me transferimin e z. Haradinaj në Kosovë [nëse miratohet], me gjasë do të shkaktojë situatë të papranueshme sa i takon sigurisë operative, që mund të çojë edhe në trazira publike, si dhe mund të komprometojë subjekte të ndryshme të përfshira në operacionin e transferimit".¹⁵ Duke vënë në dukje paralajmërimet dhe vërejtjet e mëparshme¹⁶, Administratorja parashtron se për të mundësuar transferimin e sigurt të z. Haradinaj në Kosovë, do të ishte më mirë që të shtyhet njoftimi i z. Haradinaj dhe mbrojtësit të tij për vendimin lidhur me modifikimin e dënimit, nëse miratohet.¹⁷

14. Sa i përket sjelljes së z. Haradinaj në NJP, në Raport thuhet, ndër të tjera, se ai nuk ka marrë asnjë vërejtje ose masë disiplinore që nga 14 gushti 2023.¹⁸

III. ANALIZË

15. Kryetarja rikujton se më parë ajo konstatoi që ulja e dënimit të z. Haradinaj nuk ishte e përshtatshme dhe "ndonëse dënimi i tij mbetet ashtu siç u shqiptua nga Paneli i Gjykatës së Apelit, ai mund të modifikohet në lirimin e tij me kushte", pas marrjes

¹³ Shih Memorandumin nga Administratorja drejtuar Kryetares lidhur me Raportin e Njësisë së Paraburgimit të Kërkuar sipas Nenit 5 të Udhëzuesit të Punës mbi Uljen e Dënimit në lidhje me z. Nasim Haradinaj, me Shtojcën konfidenciale I, 11 dhjetor 2023 (konfidencial dhe *ex parte*).

¹⁴ Parashtrimet, para. 16. Shih gjithashtu Parashtrimet, para. 18.

¹⁵ Parashtrimet, para. 28.

¹⁶ Parashtrimet, para. 22-23. Shih gjithashtu Parashtrimet, para. 24.

¹⁷ Parashtrimet, para. 28.

¹⁸ Raporti, para. 10, 18. Shih gjithashtu Raportin, para. 4-9, 11-14, 19.

së raportit të Administratores “në lidhje me sjelljen e tij në NJP”.¹⁹

16. Kryetarja mori Raportin, në të cilin thuhet se z. Haradinaj nuk ka pasur asnjë incident tjetër në NJP dhe se ai ka respektuar të gjitha rregullat dhe rregulloret që nga lëshimi i Vendimit të Parë.²⁰

17. Kryetarja mban parasysh se z. Haradinaj nuk ka qenë gjithmonë i gatshëm të distancohet nga veprat penale për të cilat u dënua.²¹ Megjithatë, pas peshimit të faktorëve në tërësi, Kryetarja rikujton keqardhjen e shprehur nga z. Haradinaj gjatë seancës gojore, zotimin e tij se nuk do të përfshihet më në sjellje që mund të karakterizohen si vepra penale kundër administrimit të drejtësisë dhe se do t'i përmbushë të gjitha kushtet që mund të vendosen për lirimin e tij.²²

18. Kryetarja gjithashtu vëren se veprat penale për të cilat u dënua z. Haradinaj, janë të rënda dhe, ndonëse ai ka treguar shenja të njëmendta të distancimit nga veprat penale të tij dhe disa shenja pozitive rehabilitimi, është me rëndësi të sigurohet vazhdimi i rehabilitimit dhe distancimit të plotë të z. Haradinaj nga veprat për të cilat është dënuar përmes respektimit të kushteve të përcaktuara në paragrafin 21 më poshtë.

19. Për këtë qëllim, Kryetarja është e mendimit se dënimi i z. Haradinaj mund të modifikohet duke urdhëruar lirimin e tij, me disa kushte të caktuara. Këto kushte do të jenë në fuqi gjatë gjithë kohëzgjatjes së dënimit me burgim që i është shqiptuar z. Haradinaj ose deri në një datë të mëhershme të specifikuar.²³

20. Së fundi, në përputhje me nenin me nenin 11(2) të Udhëzuesit të Punës, Kryetarja mund të vendosë të anulojë ose modifikojë vendimin e saj, nëse personi i

¹⁹ Shih Vendimin e Parë, para. 66-69, 76, 78.

²⁰ Raporti, para. 10, 18.

²¹ Vendimi i Parë, para. 68.

²² Transkripti i seancës, 28 shtator 2023, f. 11-12.

²³ Shih nenin 11(1) të Udhëzuesit të Punës.

dënuar shkel një ose më shumë prej kushteve që i janë caktuar.

IV. PËRFUNDIM

21. Duke pasur parasysh sa më lart, dhe pasi ka shqyrtuar tërësinë e informacionit që i është paraqitur, përfshirë Raportin, Kryetarja vendos që për lirimin e z. Haradinaj në përputhje me rregullën 196(4) të Rregullores dhe nenin 11(1) të Udhëzuesit të Punës, për pjesën e mbetur të dënimit të shqiptuar nga Paneli i Gjykatës së Apelit, të zbatohen kushtet në vijim:

- a) garancia se do të banojë tërë kohën në adresën e shtëpisë, shënuar në Parashtrimet e Haradinajt;²⁴
- b) të informojë Administratoren dhe stacionin e policisë të identifikuar nga Administratorja për ndërrimin e vendbanimit të përhershëm, në varësi të miratimit nga Kryetarja;
- c) të paraqitet çdo javë në stacionin e policisë të identifikuar nga Administratorja;
- d) Administratores t'i dorëzohet pasaporta ose dokumentet e udhëtimit të z. Haradinaj;
- e) të qëndrojë në Kosovë dhe të informojë Administratoren në rast se dëshiron të udhëtojë jashtë Kosovës dhe kërkesa për leje për udhëtim të miratohet nga Kryetarja;
- f) të mos kontaktojë, as të komunikojë me dëshmitarë ose viktime (të mundshme) para Dhomave të Specializuara dhe ZPS;
- g) të mos japë deklarata publike drejtpërdrejt ose tërthorazi (vetë ose përmes

²⁴ Parashtrimet e Haradinajt, para. 39

të tjerëve) lidhur me Dhomat e Specializuara dhe ZPS në;

- h) të kërkojë leje dhe miratim nga Administratorja për intervista ose çfarëdo kontakti tjetër me median, sikurse përcaktohet në Udhëzuesin e Punës për të Paraburgosurit (Komunikimet me Mediat);
- i) të përmbushë vendimet ose urdhrat e Dhomave të Specializuara; dhe
- j) të mos bëjë komente negative, të dhunshme, frikësuese, kërcënuese ose shtrënguese ndaj ose rreth dëshmitarëve (të mundshëm) ose personave të tjerë që janë të rrezikuar për shkak të bashkëpunimit të tyre me Dhomat e Specializuara, dhe ndaj ose rreth zyrtarëve të Dhomave të Specializuara ose të ZPS së.

22. Kryetarja thekson se kushtet e përcaktuara më lart lidhur me lirimin e z. Haradinaj, mbeten në fuqi për pjesën e mbetur të dënimit prej katër vjet e tre muaj të shqiptuar nga Paneli i Gjykatës së Apelit, konkretisht deri më 24 dhjetor 2024. Kryetarja thekson gjithashtu se mospërmbushja prej z. Haradinaj e kushteve të përcaktuara në paragrafin 21 do të rezultojë në anulimin ose ndryshimin e vendimit aktual në përputhje me nenin 11(2) të Udhëzuesit të Punës.

23. Kryetarja mban parasysh shqetësimet e shprehura nga Administratorja lidhur me sigurinë operative nëse z. Haradinaj ose mbrojtësi i tij njoftohen për këtë vendim përpara transferimit të z. Haradinaj në Kosovë. Rrjedhimisht, Kryetarja gjykon që ky urdhër duhet t'u dorëzohet z. Haradinaj dhe mbrojtësit të tij vetëm pas konfirmimit për mbërritjen e z. Haradinaj në vendin e caktuar të lirit më 14 dhjetor ose rreth asaj date.

24. Duke marrë parasysh se dënimi modifikohet me këtë vendim, rishikimi lidhur me ndryshimin e dënimit është i tejkaluar.

V. VENDIM

25. Bazuar në sa më lart, Kryetarja:

VENDOS të modifikojë dënimin e z. Haradinaj duke e liruar me kushtet e përcaktuara në paragrafin 21 më lart;

VENDOS që, në varësi të organizimit të transferimit nga Administratorja, z. Haradinaj të lirohet më 14 dhjetor 2023, ose rreth asaj date, në vendbanimin e tij të përhershëm, në adresën e shtëpisë, shënuar në Parashtrimet e Haradinajt;

URDHËRON z. Haradinaj të përmbushë kushtet e përcaktuara në paragrafin 21 më lart;

URDHËRON Administratoren të marrë të gjitha masat e nevojshme për transferimin e z. Haradinaj në adresën e shtëpisë, shënuar në Parashtrimet e Haradinajt dhe me kushtet e përcaktuara në paragrafin 21 më lart;

URDHËRON policinë e Kosovës ose çdo autoritet tjetër në Kosovë që, në përputhje me nenin 51(1) të Ligjit, të bashkëpunojë me Administratoren për zbatimin e kushteve të përcaktuara në paragrafin 21 më lart dhe t'i dorëzojë Administratores raport mujor lidhur me përmbushjen prej z. Haradinaj të kushteve të përcaktuara në paragrafin 21(c) më lart;

URDHËRON Administratoren t'i raportojë Kryetares çdo muaj lidhur me përmbushjen prej z. Haradinaj të kushteve të përcaktuara në paragrafin 21 më lart, deri në përfundimin e dënimit të tij prej katër vjet e tre muaj, konkretisht më 24 dhjetor 2024, ose më herët në rast të shkeljes së kushteve;

URDHËRON Njësinë për Administrimin e Gjykatës ("NJAGJ") të riklasifikojë vendimin si publik pas konfirmimit të Administratores për mbërritjen e z. Haradinaj në vendin e caktuar të lirimit;

URDHËRON NJAGJ në t'ia dorëzojë këtë vendim z. Haradinaj dhe mbrojtësit të tij dhe Prokurores së Specializuar vetëm pas konfirmimit për mbërritjen e z. Haradinaj në Kosovë; dhe

URDHËRON NJAGJ në të sigurojë që shtojcat e këtij vendimi të mbeten konfidenciale dhe *ex parte*, sikurse pasqyrohet në ballinat e tyre përkatëse.

/nënshkrimi/

**Gjykatëse Ekaterina Trendafilova,
Kryetare e Dhomave të Specializuara**

E martë, 12 dhjetor 2023
Hagë,
Holandë